

**VENDIM**  
**Nr. 657, datë 2.9.2026**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 80, DATË 14.2.2023, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE PËR  
PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E DOKUMENTEVE BIOMETRIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 105, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik dhe digjital të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 7, e vendimit nr. 80, datë 14.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shoqëria aksionare administron dhe zhvillon, nëpërmjet furnizimit nga shoqëria “ALBTraceCo” sh.a., me kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës dhe teknologjive të sigurisë së lartë, që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave sensitive të shtetasve, identitetin dhe të dhënat biometrike, dokumentet fizike biometrike boshe, zhvillimin, integrimin ose administrimin e platformave dhe sistemeve kritike shtetërore, shërbime shtesë në funksion të prodhimit të shpërndarjes së dokumenteve biometrike, përfshirë projektimin, zhvillimin, implementimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike që lidhen me identitetin biometrik, identitetin digjital, identifikimin elektronik, autentifikimin, gjurmueshmërinë, verifikimin elektronik, si dhe çdo shërbim tjetër teknologjik ose të integruar që shërben për realizimin e këtij qëllimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike dhe shoqëria “ALBTraceCo” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**